



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01- 4996/20
Kaçanik, 24.02.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II-të** (Dytë) e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24 Shkurt 2020. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Albana Troni.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Kryetari i Komunës –Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive; Ramadush Osmani, Zahir Doda, Bahri Selimi, Ukshin Qallaku dhe Festim Neziraj.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e II-të (Dytë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2020, data 24 Shkurt 2020, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-a;
2. Propozim Rregullorë për Taksat Komunale;
3. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019;
4. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2019;
5. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019;
6. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019; dhe

7. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqës 400m² të klasës së 5, në Zonën Kadastrale Nikaj, në emër të Bajram Guri.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin;

z. Ekrem Kyçyku, Kërkoj që për mbledhjen e muajit mars të hynë në shqyrtim:

1. Çështja e kompensimit të komisioneve të Kuvendit të Komunës; dhe
2. Çështja e zbatimi i ligjit kundër duhanit.

z. Nexhat Loku, Pajtohem me propozimet e z. Ekrem Kyçyku, ndërkaq unë kërkoj që çështja e kompensimit të komisioneve të KK të hynë në rend pune në këtë mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit, Çështja e zbatimit të ligjit kundër duhanit, duhet të na vjen si Informatë për shqyrtim, ndërkaq çështja e kompensimit të komisioneve të KK, duhet të na vjen me Propozim Vendim të DEFZH. Disa komuna veç kanë bërë zgjidhje e pagesës së komisioneve të KK dhe po i paguajnë komisionet.

z. Bahri Selimi, Çështja e kompensimit të komisioneve nuk është e rregulluar. Po të ishte e rregulluar, atëherë ne si drejtori i kishim marrë veprimet e nevojshme për përgatitjen e Propozim Vendimit konform dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë fushë. Ju gjeni ndonjë mënyrë për çështjen e kompensimit të komisioneve, atëherë unë do të marrë veprime të nevojshme me ua bërë kompensimet.

z. Ekrem Kyçyku, Pasi nuk ka disponim , atëherë mos të diskutojmë sot më këto çështje, por të njëjtat të hynë në rend pune në mbledhjen vijuese të KPF dhe KK për shqyrtim.

Kryesuesi i Kuvendit, Atëherë rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit është njëzëri me punuar me këtë rend pune. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF, e,

APROVOJ

Rendin e propozuar të punës, në përbërje 7 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhës së I-r (Parë) të Rregullt të KPF-a, mbajtur me datë 27 Janar 2020 / 01Nr. 060/01- 2083/20.

2. Propozim Rregullore për Taksat Komunale;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush di\ka me këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Të neni 8, propozoj të lirohen nga pagesa e taksave për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare edhe kategoria e ish të burosurve politikë, kur dihet së me një lirim nga këto taksa iu bënë nderë këtyre kategorive.

Të ndërrimi i destinimit të tokave bujqësore në tokë ndërtimore, të ngritën takast nga 1€ sa është përcaktuar taksa në 2€. Të vendosja e foltoreve telefonike, propozoj të hiqet krejt taksat, për shkak se nuk besoj se do të kemi më vendosje të foltoreve telefonike.

z. Selim Reka, Të neni 11 pika 1.24 të Kërkesa për tërheqjen e nështetësisë, kërkoj që taksa të rritet nga 20€ sa është propozuar të bëhet 50€. Të Kapitulli 7, pika 1.11, të Bazenet për kultivimin e peshqëve, taksa 2€ për m2, propozoj të hiqet krejt kjo taksë edhe pse është e vogël, në mënyrë që të stimulohen këto biznese të kultivimit të peshqve. Të Parkingjet, e mbështeti rritjen e taksës nga 0.20€ në 0.30€.

z. Ramadush Osmani, Iu njoftoj së për herë të parë është në kompetencë të komunës çështja e vendosjes së taksës për mbeturina për amvisëri, biznese etj. Taksa për amvisëri është 5€, ndërkaq të veprimtaritë ka taksa të tjera. E juaja është më vendosur se a do të jeni të pajtimit me këto taksa apo do t'i ndryshoni.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë me këto ndryshime Draft rregullorja e Taksave Komunale e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Rregullorë për Taksat Komunale; dhe e njëjta i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, Kryetari i Komunës Besim Ilazi është present në mbledhje për me arsyetuar raportin. Nëse ka Kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Unë e kam lexuar këtë raport pune dhe kam bërë krahasime me Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019. Të DBPZHR, janë konfiskuar 69.02m3-apo shprehur në hapësirë 98.69 mh, me çka kujtoj se janë pak dru të konfiskuara në raport me shkatërrimin e pyjeve dhe kjo të bënë me kuprtuar se nuk ka pasur monitorim të prerjes së pyjeve. Udhëzim Administrativ për sipërfaqe të zhveshura nuk ka pasur. Të DAP nuk janë me fletëlëshim të gjitha hyrje -daljet Të DSHMS, Kontrolla për ujin e pijës, janë realizuar vetëm 6 për një vit, e që është shumë numër i vogël i kontrollave të ujit të pijes, kur dihet cilësia e ujit të pijes.

z. Selim Reka, Materiali është i gjerë. Nga raporti shihet se janë realizuar shumë projekte, ndërkaq realizimi i tyre është i dobët, sepse nuk po shkon shumë kohë e po paraqitën problem në projekte, sepse po fillon prishja e tyre. Të DBPZHR, masa drusore e konfiskuar 69.02m3-apo shprehur në hapësirë 98.69 mh. është shumë e vogël, kur dihet se pyjet e komunës tonë po shkatërrohen më të madhe. Këto dru sa e di unë ende nuk janë shpërndarë shkollave.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, kështu që a jeni të pajtimit që ky raport t'i shkoj KK në formë të informatës. KPF u pajtuan njëzëri që Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019 t'i adresohet KK në procedurë për shqyrtim. Në saje të kësaj del konstatimi së, **KPF Raportin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019 ia adreson Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim.**

4. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, vërejtjet e mia janë së raporti nuk e ka të bashkangjitur letër konfirmuese dhe nuk është i nënshkruar nga Kryetari i Komunës. Fillimisht fjalën e ka drejtori i DEF, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Raporti është dërguar në MEF dhe i njëjti nuk ka pasur mundësi me u pranuar pa letër konfirmuese dhe pa nënshkrimin e Kryetarit të Komunës. Për Kuvend raportin financiar është hartuar në formë informate me qenë më i kuptueshëm për anëtarët e KK, sepse qysh hartohet raporti sipas standardeve e keni më të vështirë me e kuptuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush me diskutuar, e hapi diskutimin e kësaj pike:

z. Nexhat Loku, Të tabela me Nr. 2 është shënuar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2020. Në f.7, Shënohet : Paga dhe Rroga, ndërkaq duhet të jetë, Paga dhe Mëditje. Të Shërbimet kontigjente, janë detyrime shumë të mëdha të kontesteve gjyqësore. A ka mundësi komuna të hjek dorë nga një parcela e Tushëve, parcela afër banesës së madhe e mos me paguar, ndërkaq më intereson të di, cili është roli i Avokatit publik të komunës që nuk po mundet me i mbrojtur kontestet gjyqësore.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Të pyetja e Nexhatit, vendimi i gjykatës është i viteve 80-ta , janë kryer të gjitha procedurat, ndërkaq nuk është gjetur ndonjë argument se iu ka bërë kompensimi i pronës pronarit. Parcela kadastrale nuk na duhet, por çështja është së jemi të vonuar në këtë drejtim. Të kontesti i Elife Murseli, edhe pse e kemi vendimin e KPM, Gjykata na e ka këthyer ndryshe vendimin nga ai i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës.

z. Ekrem Kyçyku, Raportin ne si KPF e kemi jo të plotë , me 30 faqe nga 59, ndërkaq unë kujtoj se nuk bënë më supozuar së nuk e kuptojmë raportin financiar. Pavarësisht sesa e kuptojmë është mirë raporti të jetë identik me atë që dërgohet në ministri.

z. Selim Reka, Unë mendoj se për humbjen e kontesteve gjyqësore, dikush duhet të shkoj në përgjegjësi, qoftë zyrtari apo avokati. Realizimi i të HVK është 90% i arkëtuar, ndërkaq sa herë duhet të insistohet të arrihet 100%. Nga raporti shihet se mjete buxhetore do herë mbesin për t'u bartuar në vitin vijues.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë shpenzimet për udhëtime jashtë vendit nuk i pash së janë përfshirë në këtë raport.

z. Bahri Selimi, Çështja e shpenzimeve për udhëtimin e anëtarëve të KK në Shqipëri janë të përfshira, por janë keqklasifikuar-keqregjistruar-janë bërë gabime teknike. Vendimet e gjykatave i sqaroj Kryetari i Komunës. Të shpenzimet kontigjente, nëse ne nuk ia

procedojmë mjetet, përmbaruesi privat na i merr mjetet nga xhirollogaria bankare e komunës.

U kërkoj falje nëse kam thënë se nuk e kuptojnë raportin financiar anëtarët e KK. Nëse e kam thënë pa vetëdije, tërheq fjalën time, sepse e kam pasur në kuptimin më të mirë hartimin e informatës si informatë shtesë.

z. Ekrem Kyçyku, Tabelën për të HVK sipas sektorëve nuk e kemi, ndërkaq në vitet tjera raportin e ka pasur tabelë më të dhënat për të HVK.

z. Bahri Selimi, Me standarde të reja, të HVK po kërkohen të hyrat tatimore dhe të hyrat jo tatimore. Tabela me të HVK mund t'i përcjellim KK në bazë të kërkesës së juaj.

Në f.18 të Informatës janë paraqitur të hyrat nga tatimit në pronë. Ju njoftoj se tatimi në pronë ka shënuar ngritje për 20%.

znj. Hafize Sallahu, Nuk mund të jetë shqetësim i drejtorit a e kuptojmë ne anëtarët e KK apo jo raportin financiar. Aty ku kemi paqartësi, ne mund të kërkojmë sqarime shtesë drejtorit, ndërkaq nuk bënë më thënë se nuk e kuptojmë raportin financiar, se në fund të fundit ne jemi të zgjedhur e popullit e nuk kemi ardhur vet në KK.

znj. Pranvera Loku, Drejtori duhet me na dërguar raportin e njëjtë ashtu si është dërguar në MEF, ndërkaq nuk duhet të shqetësohet se a e kuptojmë ne anëtarët e KK apo jo raportin financiar.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky raport të shkoj në procedurë të KK. KPF njëzëri u pajtua që raporti financiar t'i adresohet KK më këto ndryshime. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF së, **Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2019; ia kalon Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim.**

5. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, raporti është hartuar nga KPF në bashkëpunim me zyrtarën e KK Makfire Malsiu. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë konstatoj së,

Raportin e Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019, KPF-a ia rekomandon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimit e vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

APROVOJ

Propozim Vendimi për ndryshim plotësimit e vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

7. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqës 400m² të klasës së 5, në Zonën Kadastrale Nikaj, në emër të Bajram Guri.

Kryesuesi i Kuvendit, Edhe për këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF mori këtë,

VENDIM

Me të cilin MIRATOHET Propozim Vendimi i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06-350/02-8709/20 -Për Lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të BAJRAM GURI nga f. Nikaj në sipërfaqe, 400m², në PK Nr. 00404-0 në sipërfaqe të përgjithshme 400m², Zona Kadastrale Nikaj, me kulturë, Arë e klasës së 5(Pestë), pronë private në emër të Bajram(Hilmi) Guri, sipas Certifikatës së pronës me Nr. 70917064-00404-0.

Kryesuesi i Kuvendit, Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, Mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:05. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 6 anëtarë, ndërkaq anëtari Nexhat Loku me lejen e Kryesuesit doli më herët nga mbledhja.

Mbledhja e Kuvendit të Komunës është caktuar për datë, 28 Shkurt 2020, në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli
Kemal Mërseli

